



Rruga “Nikolla Tuce”, Nr. 1, Kati 3
Tiranë, Shqipëri
NIPT: K52311009R
+355 69 60 60 058
www.credinsinvest.com

Raport Mjor për fondin Credins Dynamic

Portofoli i Fondit Credins DYNAMIC, në përputhje me Politikën e Investimit, do të përbëhet kryesisht nga obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose vendeve të Bashkimit Europian të denominuara në monedhën Euro, si dhe kuota të fondeve të investimeve (SIK/ETF).

Data e raportit: 31.01.2026

Informacion për Fondin

Shoqëria Administruese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	15 shtator 2025
Perioda e akumulimit	15 shtator – 15 tetor 2025
Monedha e Fondit:	Euro

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë:

- ✓ një normë kthimi më të lartë se produktet bankare në Euro,
- ✓ likuiditetin që i mungon këtyre produkteve.

Profil i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit obligacioneve dhe të cmimit kuotave të fondeve të investimit ku investon Fondi.

Rrezik i ulët Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të ulëta Përfitimet tipike më të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi CREDINS DYNAMIC ka një profil rreziku në nivelin 3, pra të mesëm.

Të dhëna kryesore për Fondin


Vlera Neto e Aseteve	518,157.10 Euro
Çmimi i kuotës	100.7287 Euro
Kthimi nga investimi (15.10.2025 – 31.01.2026)	0.73%

Fondi i Investimit “Credins Dynamic” është fond investimi me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike i emetuar në monedhën Euro. Ky Fond përbën një mundësi investimi për të gjithë investitorët individ apo institucional që kanë një horizont investimi afatmesëm dhe që kërkojnë kthime nga investimi i tyre në monedhën Euro, duke investuar me një profil rreziku të mesëm.

Mbajtësit e kuotave të Fondit janë njëkohësisht pjesëmarrës indirekt në një gamë të gjerë investimesh në vende të BE-së, dhe në sektorë të ndryshëm industrial, duke diversifikuar kështu rrezikun e tregut nëpërmjet administrimit profesional asetave të Fondit.

Shoqëria Administruese synon të krijojë një portofol të balancuar përsa i përket maturitetit dhe gamës së instrumenteve financiare në të cilat investohen asetet e Fondit.

Ekspozimi sipas llojit të instrumentit



Portofoli i Fondit në 31.01.2026

Instrumented kryesore të Portofolit	Alokimi si % Asetesh	Kthimi i muajt Janar 2026
Eurobond i Shtetit Shqiptar	28.52%	-0.02%
Eurobond i Shtetit Rumun	25.52%	1.71%
iShares Global Corp Bond EUR Hedged UCITS ETF (Dist)	19.29%	0.23%
SPDR® MSCI All Country World EUR Hdg UCITS ETF (Acc)	4.96%	2.23%

Karakteristikat e rrezikut të asetave në Fond

Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e rrimimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i rrimimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.


Obligacionet qeveritare

Këto asetë janë të emetuara nga shteti shqiptar në monedhën Euro, ose janë të emetuar ose të garantuara nga autoritete qendrore, rajonale ose vendore të BE-së, ose nga çdo shtet i miratuar nga AMF në monedhën Euro të tregtuara në tregje të rregulluara ndërkombëtare. Obligacionet qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti (“rating”) të ndryshme.

Kuota të fondeve të investimeve (SIK/ETF)

Kuota të fondeve të investimeve (SIK) ose të fondeve të investimeve të tregtuara në bursë (ETF) janë kuota fondesh të cilat i përmbahen një politike investimi dhe riskut të përcaktuar. Këto instrumente ekspozohen nga risku i luhatshmerisë të cmimit dhe mbartin riskun e totalit të instrumenteve që formojnë portofolin e këtyre fondeve.

*Për më tepër informacion rreth rreziqeve të Fondit, ju lutem referojuni seksionit përkatës në Prospektin e Fondit Credins Dynamic.



Aksionet kryesore përfshijnë: NVIDIA CORP 4.86%, APPLE INC 4.02%, MICROSOFT CORP 3.16%, AMAZON.COM INC 2.39%.

Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një produkti. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë www.credinsinvest.com.